



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 080/20
Prishtinë, më 17 korrik 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 17 DHE 20 KORRIK 2009

Seancën e drejtoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 72 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në fillim të seancës, për fjalë u paraqiten këta deputetë:

Deputeti **Arsim Rexhepi** ngriti çështje e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në komunën e Vushtrisë, siç janë: Fabrika e tekstilit “Vushteks”, Fabrikën e llaqeve dhe ngjyrave “Ekstra”

dhe ajo e llamarinës “Llamkos”, të cilat, sipas tij, kanë dështuar. Ai kërkoi nga Qeveria e Kosovës që të marrë veprime konkrete për të dalë nga kjo situatë e vështirë.

Deputeti **Gani Buçinca** ngriti shqetësimin lidhur me aktin e dhunshëm që kishte ndodhur ditë më parë nga disa veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ndaj institucioneve qeveritare. Ai kërkoi që Kuvendi të nxjerrë një deklaratë me të cilën dënohen aktet e dhunës, ndërsa problemet reale të veteranëve të zgjidhen në mënyrë institucionale. Ai shtoi se prapa këtij akti të dhunshëm qëndron AAK-ja.

Deputeti **Dritan Tali** kërkoi sqarime nga Qeveria e Kosovës lidhur me vendimin që ajo kishte marrë për ndërtimin e termocentralit “Kosova C” apo “Kosova e Re” me kapacitet 2000 megavatesh. Ai kërkoi që Kuvendi të debatojë lidhur me vendimin e Qeverisë për këtë çështje.

Deputeti **Ardian Gjini** mohoi konstatimin e deputetit Buçinca se kinse AAA-ja qëndron prapa akteve të dhunshme. Ai kërkoi nga PDK-ja dhe Kuvendi që të distancohet nga konstatimet e deputetit Buçinca.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj çështjeve që ngriti deputeti Arsim Rexhepi lidhur me procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në komunën e Vushtrisë dhe të deputetit Driton Tali lidhur me ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”.

Kryetari propozoi që kohëzgjatja e diskutimeve për deputetë të jetë deri në pesë (5) minuta, ndërsa për kryetarë të grupeve parlamentare deri në dhjetë (10) minuta.

Ai hodhi në votim propozimin e kohëzgjatjes së diskutimeve. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ... shumica absolute,
Kundër.....1,
Abstenime.....1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin për kohëzgjatjen e diskutimeve.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008,
4. Shqyrtimi i Raportit të audituar të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Pasqyrave Financiare për vitin 2008,
5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit Qendror të zgjedhjeve, për vitin 2008,
6. Shqyrtimi i Raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2008,
7. Debat lidhur me gjendjen në Radio-Televizionin e Kosovës, sipas kërkesës së një grupi të deputetëve,

8. Shqyrtimi Rekomandimit të Komisioni Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës nga komuniteti serb,
9. Propozimi i Grupit Parlamentar “7+” për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme

Kuvendi miratoi, pa vërejtje, procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 25 qershor 2009.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Myrvete Pantina, parashtroi pyetje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Idriz Vehapi, lidhur me fondin bujqësor në rast të fatkeqësive.

Ministri Vehapi iu përgjigj pyetjes së deputetes Myrvete Pantina.

Deputeti Naim Rustemi, parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me respektimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Rustemi.

Deputeti, Driton Tali, parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me manaxhmentin operues dhe atë mbikëqyrës kontribues kosovar?

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti Riza Smaka, parashtroi pyetje për ministrin e Shëndetësisë, Alush Gashi, lidhur me dispozitat e nenit 13 të Ligjit Nr 03/L-016 për ushqimin

Ministri Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputetja Sanije Aliaj, parashtroi pyetje për Kryeministrin, Hashim Thaçi, lidhur me Projektin rezoluten për programin e Kosovës për barazi gjinore.
Zëvendës Kryeministri Hajredin Kuqi iu përgjigj pyetjes së deputetes Alijaj.

Deputetja Fatmire Berisha, parashtroi pyetje për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, lidhur me statusin e të vrarëve në luftë.

Ministri Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Berisha.

Deputeti Naser Rugova, parashtroi pyetje për ministrin e Pushtetit Lokal, Sadri Ferati, lidhur me mosfunksionalizimin e tregut multi-etnik në afërsi të urës lindore në Mitrovicë.

Ministri Sadri Ferati iu përgjigj pyetjes së deputetit Rugova.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e raportit të Komisionit Evropian për vitin 2008.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Integritet Evropian, në koordinim me komisionet e tjera parlamentare, ka hartuar dhe Kuvendit i ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim raportin e parë të Progresit për planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008.

Në emër të Komisionit për Integritet Evropian **Zylfije Hundozi** tha se Rritja e eksperiencës dhe kapaciteteve për tejkalimin e sfidave që sjell me vete procesi i integriteteve evropiane është prioritet kyç i shtetit të Kosovës. Raporti i sotëm paraqet një angazhim shtesë të të gjitha komisioneve parlamentare që të kontribuojnë në këtë proces. Sa i përket sfidave të identifikuar në Raportin e progresit të paraqitur në nëntor të vitit 2008 nga ana e Komisionit Evropian, ka pasur të arritura të të gjitha institucionet e Kuvendit të Kosovës, Qeverisë dhe institucioneve të pavarura, Komisioni për Integritet Evropian i jep këto rekomandime; për Kuvendin e Kosovës, që Komisionet parlamentare të fillojnë të zbatojnë vendimin e seancës plenare për përfshirjen në rend të ditës të secilës mbledhje - integritet evropian.

Komisioni parlamentar nëpërmjet zyrtarëve mbështet mundësinë që të përçojnë informacione të mbledhura të Kryesia e Kuvendit dhe Komisioni parlamentar për Integritet Evropian për çështjet e ngritura në planin e veprimit. Qeveria për secilin projektligj duhet të dorëzojë raportin për vlerësimin e ndikimit rregullativ, krahas memorandumit shpjegues, deklaratës financiare dhe deklaratës për përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian. Qeveria dhe Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial duhet të përgatisin një plan- strategji për përmbledhjen e vendimeve të gjykatave dhe një përmbledhje të interpretimeve të ligjeve.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Raportin e parë të Progresit për Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për Sfidat e raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hydajet Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Bujar Bukoshi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Njomza Emini, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, si dhe deputetët: Vezira Emrush, Armend Zemaj, Ibrahim Gashi, Ardian Gjini, Edita Tahiri, Ibrahim Makolli, Fatmir Rexhepi, Enis Kervan, Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, Qamile Morina, Saniqe Aliaj, Nait Hasani, Myzejene Selmani, Sala Berisha-Shala, Gani Buçinca, Xhevdet Neziraj, Zef Morina, Dritan Tali, që janë paraqitur në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari hodhi në votim Raportin e parë të progresit për planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për Sfidat e raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për67,
Kundër.....2,
Abstenime.....0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin e parë të Progresit për Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për Sfidat e raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008.

4. Shqyrtimi i Raportit të audituar të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Pasqyrave financiare për vitin 2008

Kryetari i njoftoi deputetët se Bordi i Trustit Pensional të Kosovës, Kuvendit i ka paraqitur Raportin e audituar të Trustit. Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin e audituar të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe pasqyrave financiare për vitin 2008 dhe ka rekomanduar për shqyrtimin dhe miratim në seancë plenare me rekomandimet e paraqitura në raport.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, tha se Komisioni për Buxhet e Financa, në bazë të Ligjit të Trustit Pensional ose Fondit Pensional të Kosovës, ka shqyrtuar Raportin e audituar në mbledhjen e mbajtur më 22.6.2009 dhe i ka rekomanduar Kuvendit që Raporti i audituar i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe pasqyrave financiare për vitin 2008 i plotëson kushtet dhe standardet ligjore të kontabilitetit për raportim dhe është i mbështetur edhe në Ligjin për menaxhimin e financave. Komisioni i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës që në seancën plenare, të sotme, ta miratojë këtë raport të pasqyrave financiare për vitin 2008. Gjithashtu, Komisioni i ka rekomanduar Kryesisë së Kuvendit që në seancë plenare me rastin e shqyrtimit të Raportit të audituar të Trustit të Kursimeve dhe të pasqyrave financiare për vitin 2008, të ftohet edhe kryesuesi i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, që të raportojë në Kuvend. Komisioni me qëllim të krijimit sa më të mirë të një baze ligjore për shfrytëzimin investimin dhe menaxhimin e mjeteve të Trustit Pensional të Kosovës, i rekomandon Kuvendit që të kërkojë nga Qeveria, gjithnjë mbi në të Ligjit dhe kompetencave që ka për formimin e një grupi të punës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të kursimeve pensionale në Kosovë.

Kryesuesi i Bordit të Trustit Pensional të Kosovës, **Besim Beqaj** tha se Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës në këtë raport reflekton gjetje të cilat kanë qenë në vitin 2008 dhe që bordi aktual nuk është drejtpërdrejt përgjegjës për këtë auditim. Me ligj nga Trusti kërkohet që ta informojë Kuvendin dhe Bankën Qendrore të Kosovës për çështjet që do t'i specifikojë, Raportet e kontrolluara të llogarive vjetore të aktivitetit dhe pasivitetit, të ardhurat dhe shpenzimet e kontrolluara dhe të nënshkruara nga auditori i certifikuar në përputhje me standardet e kontabilitetit ndërkombëtar apo me standarde të tjera, të cilat janë të miratuara nga Banka Qendrore dhe në pajtim me ligjet në fuqi.

Raportet tremujore, duke përfshirë hollësitë për shitjen dhe fitimin e mjeteve pensionale, së bashku me identitetin e mjeteve, datën e transaksionit, çmimin me të cilin është bërë transaksioni dhe ndërmjetësi që është shfrytëzuar, raportet vjetore për vlerën dhe proporcionin e mjeteve pensionale të cilat janë investuar në klasa të veçanta të mjeteve, duke përfshirë hollësitë e dhënësve të letrave me vlerë nga data e vlerësimit të fundit, si dhe raportet vjetore për të gjitha pagesat. Për shembull, pagesat e mbajtjes dhe pagesat e tjera për shërbime dhe transaksione financiare.

Për gjashtë vjet operimi, auditorët gjithmonë kanë dhënë vlerësime të pastra.

Për auditim të jashtëm nga bordi paraprak është përzgjedhur kompania Di Loid and Tusch e cila ka audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Trustit të Kursimeve Pensionale që përfshijnë bilancin e gjendjes më 31 dhjetor 2008 dhe pasqyrën e operimeve, pasqyrën e ndryshimeve në Fondin e pjesëmarrësve dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar dhe përmbledhjen e procedurave kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e auditorit është që të shprehë opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin e tyre. Ata kanë bërë auditimin në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe standardet që janë zbatuar te ne. Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të siguruar prova për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të gabimeve materiale? Me rastin e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori merr parasysh kontrollin e brendshëm relevant dhe përgatitjen dhe prezantimin korrekt të pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnohen procedurat e auditimit. Nga auditori është vënë theksi në nevojën e bashkërendimit të pagesave dhe kontributeve nga Administrata Tatimore e Kosovës në Trustin, ku si rezultat i kësaj mangësie, më 26 mars 2009, Trusti ka pasur 28.800.000 euro të pashpërndara.

Si politikë e investimeve të këtij fondi, janë është investimet substanciale në aksionet e zakonshme. Investimet e Trustit në këtë fond janë përshkruar në valutë ekuivalente me vlerë neto të aseteve për aksion në ditën relevante të afarizmit.

Kryetari hapi debatin lidhur me Raportin e audituar të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe të pasqyrave financiare për vitin 2008

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shenik, në emër të Grupit Parlamentar SLS-së, Mursel Halili si dhe deputetët: Armend Zemaj, Qamile Morina, Myrvete Pantina, Kaqusha Jashari, Gani Koci, Dritan Tali, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi

Kryetari hodhi në votim Raportin e audituar të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe të pasqyrave financiare për vitin 2008. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për43,

Kundër.....8,

Abstenime.....7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin e audituar të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe të pasqyrave financiare për vitin 2008.

5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2008

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, ka shqyrtuar Raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2008 dhe ka rekomanduar për shqyrtimin dhe miratim në seancë plenare. Gjithashtu Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar pjesën e vet financiare të Raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2008 dhe ka rekomanduar për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni** tha se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke vepruar në pajtim me Ligjin e përgjithshëm për zgjedhjet, për herë të parë Kuvendit të Kosovës, gjegjësisht Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi i ka afruar raportin me shkrim për punën për vitin 2008. Komisioni ka konstatuar se raporti në fjalë i plotëson kriteret për t’u diskutuar dhe shqyrtuar në seancë plenare. Raporti flet për funksionimin e

Komisionit Qendror Zgjedhor për përbërjen, për infrastrukturën ligjore, për mënyrën e organizimit dhe për aktet nënligjore që i ka nxjerrë Komisioni Qendror Zgjedhor, për sfidat, problemet dhe objektivat. Rekomandime janë rreth ndërhyrjeve politike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dhe rasti ka të bëjë me zbatimin e zgjedhjeve në gjithë territorin e Kosovës edhe pse sovranit ka zgjedhur shumë kryetarë komunash, ka zgjedhur deputetë të kuvendeve komunale, këto në praktikë nuk janë zbatuar për shkak të ndërhyrjeve, qoftë ka zyrat e huaja, nuk janë certifikuar zgjedhjet, prandaj, mbetet problem serioz dhe kemi rekomanduar që Komisioni Qendror Zgjedhor për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, ta ketë parasysh që pavarësisht se a do të dalin në zgjedhje, minoritetet, njerëzit të cilët e fitojnë votën e sovranit duhet të certifikohen, sepse është e drejtë demokratike dhe ligjore që të certifikohen njerëzit të që i kanë fituar votat.

Gjithashtu, një vërejtje e cila ka qenë në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi për Komisionin Qendror Zgjedhor është edhe çështja e Komisionit për Ankesa dhe Parashpresa. Vlen të përmendet se ligji aktual, për zgjedhjet e përgjithshme dhe Ligji për zgjedhjet komunale ndoshta në të ardhmen duhet që të plotësohen dhe të ndryshohen, sepse është konstatuar që disa dispozita ligjore, që janë në fuqi, nganjëherë bien në kundërshtim me ligjet e tjera dhe me zbatimin praktik. Prandaj, kemi sugjeruar që sa më parë Komisioni Qendror Zgjedhor, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, t'i identifikojnë këto dispozita ligjore dhe të filloj procedurën edhe për ndryshim dhe plotësim.

Me këto rekomandime që janë edhe në raport, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi rekomandon që të miratohet Raporti i Komisionit Qendror Zgjedhor

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Armend Zemaj**, tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për periudhën 2008 – 2009 dhe se ky raport i plotëson standardet ligjore të kontabilitetit për raportim. Po ashtu, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin dhe informatat e ofruara, ndërsa ne i marrim parasysh edhe vërejtjet nga Komisioni funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe i rekomandojmë Kuvendit që të miratohet si i tillë.

Kryetari hapi debatin lidhur me Raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylaj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS-së, Slobodan Petroviq si dhe deputetja Edita Tahiri, të cilat janë dhënë në transkript, që është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari hodhi në votim Raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2008, me rekomandimet e Komisioneve. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për59,
Kundër.....8,
Abstenime.....4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2008, me rekomandimet e Komisioneve.

6. Shqyrtimi i Raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2008

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, ka shqyrtuar Raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008 dhe ka rekomanduar për shqyrtimin dhe miratim në seancë plenare, ndërsa Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar pjesën e vet financiare të Raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008 dhe ka rekomanduar për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni** tha se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar Raportin e Institutit Gjyqësor të Kosovës që vepron në bazë në Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor, të 23 shkurtit 2006, që është i vetmi autoritet i cili kryen të gjitha trajnimet në organet e sistemit të drejtësisë.

Pas marrjes së raportit shtesë, që ka të bëjë me çështjen e Këshillit Drejtues, Këshillit Programor të Institutit, përbërjes së Këshillit Drejtues, trajnuesve të përkohshëm dhe trajnuesve të përhershëm, Komisioni ka shqyrtuar raportin dhe konsideron që raporti në fjalë me disa rekomandime që do të dalin nga Kuvendi sot, do të miratohet.

Kryetari hapi debatin lidhur me Raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS-së, Mursel Halili si dhe deputeti Nait Hasani, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari hodhi në votim Raportin e punës së Institutit Gjyqësor për vitin 2008, me rekomandimet e Komisioneve. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për58,
Kundër.....6,
Abstenime.....3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008, me rekomandimet e komisioneve.

Kryetari deklaroi të ndërprerë seancën plenare, për të vazhduar me punimet e seancës ditën e hënë, më 20 korrik 2009, në orën 10:00.

E hëne, 20 korrik 2009, në orën 10:00
Vazhdimi i seancës plenare

7. Debat lidhur me gjendjen në Radio Televizionin e Kosovës, sipas kërkesës së një grupi të deputetëve

Kryetari njoftoi deputetet se grupi prej shtatë deputetëve, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit, ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që në seancën plenare të debatohet për gjendjen në Radio- Televizionin e Kosovës.

Kryesia e Kuvendit , në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit, e ka proceduar kërkesën e grupit të deputetëve për debat në seancë e sotme plenare.

Përfaqësuesi i grupit të deputetëve **Arsim Rexhepi** si propozues për te debatuar për gjendjen në Radio Televizionin e Kosovës, tha se Radiotelevizioni i Kosovës është themeluar mbi bazën e nevojës së patjetrësueshme të popullit të Kosovës për një televizion publik. Ai është ngritur me shumë vështirësi duke u rritur dita-ditës, nga donacionet e jashtme, nga buxheti vendor dhe nga taksat e detyrueshme për çdo amvisëri. Pra është ngritur me qëllim që t'i shërbejë informimit të popullit dhe ngritjes së jetës kulturore dhe arsimore të tij, por, të dhënat dhe diskutimet konkrete të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të Komisionit për Media të Kuvendit të Kosovës, të mbështetura në dy raportet e fundit financiare të Radiotelevizionit të Kosovës, raportit për vitin 2007 dhe atij për vitin 2008, kanë konstatuar shkelje të shumta dhe flagrante të Ligjit për prokurimin dhe të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës. Nga këto përfundime të komisioneve të lartpërmendura del se Radiotelevizioni i Kosovës posedon me gjashtë llogari bankare, duke shkelur kështu tërë Ligjin për financat publike. Kjo shumësi llogarish bankare të Radiotelevizionit të Kosovës, siç pasqyrohet edhe nga diskutimet në Kuvend, është bërë me një dhe të vetmin qëllim, për t'iu shmangur mënyrës se rregullt me anë të Thesarit dhe fshehjes dhe manipulimit të tyre.

Po ashtu, mbi bazën e raporteve të ofruara nga Radiotelevizioni i Kosovës, që zuri vend në Kuvend dhe në komisionet përkatëse, rezultoi një konstatim empirik se Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës është bord që vepron jashtë Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, të cilit i ka skaduar mandati tash e tre vjet.

Njëkohësisht, RTK ka një kontratë me Universitetin privat AAB për shkollimin dhe aftësimin e stafit të Radiotelevizionit të Kosovës. Kjo kontratë, përveç që është antiligjore, sepse është bërë pa tender dhe pa respektuar asnjë normë ligjore, ka dëmtuar rënd edhe interesat shoqërore, sepse një marrëveshje e tillë ka pasur mundësi të bëhej me Universitetin Publik dhe, nënkuptohet, të kushtojë më pak për këtë institucion.

Tendencat e drejtorit të përgjithshëm të këtij institucioni për të minimizuar me anë të storjeve të porositura problemet e mëdha në Radiotelevizionin e Kosovës, duke u përpjekur që me këtë rast të përdhosë punën e ndershme që bëhet në këtë Kuvend, se gjoja ky Kuvend paska punë më të rëndësishme se sa të debatohet për Radiotelevizionin e Kosovës, doemos tregojnë qartë mungesën e sensit, të përgjegjësisë dhe të llogaridhënies.

Andaj, ne deputetët e poshtëshënuar, kemi kërkuar këtë debat urgjent dhe i rekomandojmë këtij Kuvendi, si vijon:

1. Shkarkimin urgjent të Bordit të menaxhmentit aktual, në krye me zotin Agim Zatriqi,
2. Krijimin urgjent të Komisionit ad-hoc Hetimor që do të hulumtonte dhe konstatonte gjendjen aktuale financiare dhe ligjore e profesionale në këtë institucion publik,
3. Emërimin e një menaxhmenti të përkohshëm që do të udhëhiqte këtë medium deri në përfundimin e hetimit për të,

4. Shpalljen e konkursit të ri për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, dhe
5. Restaurimin e interesit publik dhe kthimin në misionin që kishte Radiotelevizioni i Kosovës, në shërbimin interesave të qytetarëve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Esat Brajshori, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati, si dhe deputetët: Gani Koci, Naim Rustemi, Dritan Tali, Gani Geci, Naser Rugova, Xhavit Haliti, Hajdin Abazi, Gjylnaze Syla, Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Makolli, Edita Tahiri, Vezira Emrush, Memli Krasniqi, Gani Buçinca, Ibrahim Gashi, Adem Grabovci, Berim Ramosaj, Etem Arifi, Nait Hasani, Ramë Buja, Sabri Hamiti, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Në fund të debatit, në emër të propozuesit të mocionit, deputeti **Arsim Rexhepi** tha se me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Kuvendi, me kërkesën e 1/3 së gjithë deputetëve të tij, cakton komisione për një çështje të veçantë, duke përfshirë edhe çështje hetimore. 44 deputetë e kanë nënshkruar kërkesën për krijimin e Komisionit hetimor dhe kjo me automatizëm e obligon çdo grup parlamentar që t’i emërojë, në kuadër të atij komisioni hetimor, anëtarët e vet, andaj e lus Kryetarin që ta hedhë në procedurë themelimin e këtij komisioni hetimor.

8. Shqyrtimi Rekomandimit të Komisioni Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës nga komuniteti serb

Kryetari konstatoi se kjo pike e rendit të ditës për shkak të kuorumit shtyhet për shqyrtim në seancën e ardhshme plenare.

9. Propozimi i Grupit Parlamentar “7+” për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar “7+”-së ka vendosur që anëtare në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi të emërohet deputetja Myfera Shenik, në vend të deputetit Xhezair Murati.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17:48 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**